



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 5 janar 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për tejkalimin e numri të lejuar të fjalëve në kundërpërgjigje

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullën 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzues Pune”),² nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 dhjetor 2020, Mbrojtja e Hashim Thaçit (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi kërkesë për lirimin e përkohshëm të tij.³ Më 16 dhjetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) e kundërshtoi mocionin.⁴

2. Më 7 dhe 17 dhjetor 2020, edhe ekipet e Mbrojtjes të tre të akuzuarve të tjerë dorëzuan mocione për lirimin e përkohshëm të tyre.⁵ ZPS-ja iu përgjigj këtyre kërkesave më 17 dhjetor 2020 dhe 4 janar 2021.⁶

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara (KSC-BD-15), 17 maj 2019.

³ KSC-BC-2020-06, F00120/RED, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë për lirim të përkohshëm në emër të z. Hashim Thaçi*, 4 dhjetor 2020, publike.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00149/RED, Prokurori I Specializuar, *Version i redaktuar publik i përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Hashim Thaçi*, 21 dhjetor 2020, publik, para. 1, me shtojcën 1, publike dhe shtojcën 2, konfidenciale.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00122/RED, Mbrojtja e Krasniqit, *Version i redaktuar publik i kërkesës për lirim të përkohshëm*, KSC-BC-2020-06/F00122, 7 dhjetor 2020, 18 dhjetor 2020, publik, me shtojcat 1-3, publike; F00124/RED, Mbrojtja e Selimit, *Version i redaktuar publik i kërkesës për lirim të përkohshëm*, KSC-BC-2020-06/F00124, 7 dhjetor 2020, 12 dhjetor 2020, publik, me shtojcat 1-3, publike; F00151, Mbrojtja e Veselit, *Kërkesë për lirim të përkohshëm të Kadri Veselit*, 17 dhjetor 2020, konfidenciale, me shtojcat 1-7, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00153/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i redaktuar publik i përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Jakup Krasniqi*, 22 dhjetor 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale; F00154/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i redaktuar publik i përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Rexhep Selimi*, 22 dhjetor 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale; F00161, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Kadri Veseli*, 4 janar 2021, konfidenciale, me shtojcën 1, konfidenciale.

3. Më 18 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi Mbrojtjen e z. Thaçi, si dhe Mbrojtjen e Rexhep Selimit dhe Mbrojtjen e Jakup Krasniqit, të dorëzojnë kundërpërgjigjet e tyre përkatëse deri më 7 janar 2021.⁷

4. Më 4 janar 2021, në pajtim me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, Mbrojtja e Thaçit kërkoi tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve për kundërpërgjigjen e ardhshme ("kërkesa").⁸ Në të njëjtën ditë, ZPS-ja iu përgjigj kërkesës ("përgjigja").⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE

5. Në bazë të nenit 41 të Udhëzuesit të Punës, përgjigja ndaj mocionit nuk duhet të tejkalojë 2000 fjalë.

6. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, një pjesëmarrës në proces mund t'i kërkojë leje panelit paraprakisht mjaftueshëm në kohë për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, nëse tregon se ka arsye të vlefshme për rrethana të posaçme.

7. Në pajtim me rregullën 82(5) të Rregullores, trupi gjykues mund të ndryshojë statusin e një parashtrimi të protokolluar, me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces apo *proprio motu*.

III. DISKUTIM

8. Mbrojtja e z. Thaçi parashtron se kërkon tejkalim të numrit të lejuar të fjalëve deri në 6000 fjalë për kundërpërgjigjen e saj, në mënyrë që të paraqesë argumente

⁷ KSC-BC-2020-06, F00155, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim lidhur me kërkesën e Mbrojtjes për shtyrjen e afateve*, 18 dhjetor 2020, publik, para. 23.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00158, Mbrojtja e Thaçit, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve*, 4 janar 2021 konfidenciale, para. 1.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00160, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit lidhur me tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve*, 4 janar 2021, konfidenciale.

të shtjelluara mirë, si nga ana juridike dhe nga ajo faktike, për të paktën shtatë pretendimet e reja kundër Thaçit të ngritura në përgjigje dhe në materialin bashkëngjitur prej 200 faqesh.¹⁰ Gjithashtu, Mbrojtja nuk kundërshton kërkesën që të riklasifikohet si material publik.¹¹

9. ZPS-ja nuk kundërshton që Mbrojtjes t'i miratohet një tejkalim i arsyeshëm i numrit të fjalëve dhe nuk kundërshton që kërkesa të riklasifikohet si publike.¹²

10. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se kërkesa për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve është dorëzuar paraprakisht në kohë të mjaftueshme në rrethanat aktuale, konkretisht ditën e parë pas periudhës së pushimit të Gjykatës, pas përgjigjes së ZPS-së, dhe tri ditë pune para afatit për dorëzimin e kundërpërgjigjes së ardhshme. Duke mbajtur parasysh numrin e pikave dhe vëllimin e materialit të cilave kërkon t'u përgjigjet Mbrojtja e Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ka arsye të vlefshme që përbëjnë rrethana të posaçme për të miratuar tejkalimin e numrit të fjalëve lidhur me çështjen konkrete. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton tejkalimin e numrit të fjalëve deri në 6000.

11. Në interes të ekonomisë gjyqësore dhe duke pasur parasysh se ekipet e Mbrojtjes së tre akuzuarve të tjerë mund të kërkojnë mjet të ngjashëm ligjor për çështjen konkrete, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon të njëjtin tejkalim të numrit të lejuar të fjalëve për tre ekipet e tjera të Mbrojtjes, në rast se dëshirojnë të dorëzojnë kundërpërgjigje.

IV. VENDIM

12. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

¹⁰ Kërkesa, para 14-15.

¹¹ Kërkesa, para. 2.

¹² Kërkesa, para. 1-2.

- a) **MIRATON** kërkesën për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve deri në 6000 në kundërpërgjigjen e Mbrojtjes së Thaçit;
- b) **AUTORIZON** të njëjtin shtim të numrit të fjalëve në kundërpërgjigjet e ekipeve të Mbrojtjes së tre akuzuarve të tjerë, nëse do të kenë; dhe
- c) **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë F00158 dhe F00160 si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 5 janar 2021
Në Hagë, Holandë.